



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 5 dhjetor 2016, në mbledhjen e XXX (tridhjetë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.35’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Shaban Osmani, Bahri Selimi, Mefail Rama, Radisav Perović dhe Xhafer Ademi, ndërsa mungoi Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Bashkim Bajrami, Policia Kufitare, Skender Shatri dhe Bekim Karxhija, OSBE, Jozsef Bakk, KFOR dhe Nevzat Qorrolli e Xhavit Fejza, UNMIK

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbaleve të mbajtura në mbledhjet e Komitetit për Komunitete më 5 tetor 2016 dhe 26 tetor 2016

Ekstraktet e procesverbaleve u miratuan njëzëri.

3. Informim për memorandumimin e Mirëkuptimit të lidhur në mes të z. Agim Veliut, Kryetar i Komunës dhe z. Ardian Zeqirit, drejtor i Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI)

z. Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, për pjesëmarrje në këtë mbledhje u informova pak më parë, sigurisht kryetari i këtij Komiteti ka harruar të më njoftoj, mirëpo kjo për mua nuk paraqet problem ngase jam në rrjedha dhe në dijëni të plotë për përmbajtjen e këtij Memorandumi.

Përndryshe ne edhe më parë kemi pasë bashkëpunim të mirë me këtë Qendër, mirëpo tash duke u bazuar në Strategjinë për arsim dhe Udhëzimin Administrativ nr. 19/2012 është edhe obligim fuqizimi i ekipeve për parandalimin e braktisjes së shkollimit të obliguar të nxënësve në përgjithësi pra jo vetëm të komuniteteve pakicë, ekipe të cilat janë themeluar në të gjitha shkollat. Në përbërje të ekipeve të cekura përveç të tjerëve është një arsimtar i cili njëherit është anëtar i Këshillit

Drejtues të shkollës përkatëse, dhe një anëtar përfaqësues i Këshillit të prindërve. Gjithashtu është caktuar edhe koordinatori i cili koordinon punët dhe aktivitetet me ekipet e të gjitha shkollave.

Pak më parë bisedova me z. Xhafer Ademin dhe mund të them se kemi raste të braktisjes së shkollimit, për fat të mirë janë raste të pakta, mund të ketë raste të paidentifikuara kur fëmija e arrin moshën për shkollim e ne për këtë nuk kemi informacion, lidhur me këtë në fshatra duke u bazuar në numrin e vogël të banorëve është më lehtë të identifikohen këto raste por vështirësitë janë në qytet ngase në lagje të ndryshme ka banorë të ardhur nga vise të tjera dhe mungojnë informacionet e nevojshme.

Problem tjetër paraqesin edhe fëmijët me nevoja të veçanta në këtë drejtim, Ekipet për parandalimin e braktisjes së shkollimit të obliguar në bashkëpunim me një shoqatë tjetër janë duke zhvilluar aktivitetet për identifikimin e fëmijëve me autizëm, për këtë qëllim janë siguruar disa mjete financiare dhe do të sigurohet edhe objekti në Shkollën “ Ibrahim Rugova “ ose “ Shaban Shala “ në mënyrë që edhe kësaj kategorie t’ju ofrohet ndihma e mundshme.

Gjithashtu jemi në përpjekje për ngritjen e kapaciteteve e zyrtarëve përkatës komunal në kuptimin e organizimit të trajnimeve duke përfshirë edhe Ekipet për parandalimin e braktisjes së shkollimit të obliguar.

Në fund e falënderoj z. Agim Veliun, Kryetar i Komunës, që e ka nënshkruar këtë Memorandum, për të cilin Drejtorja e Arsimit do të angazhohet që i njëjti edhe të zbatohet në praktikë.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, e falënderoj z. Avni Malokun për sqarime dhe informacionet e paraqitura.

z. Shaban Osmani, theksoi, lidhur me këtë çështje, pas sqarimeve të z. Avni Malokut, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, nuk kemi çfarë të shtojmë dhe konsideroj se ky Memorandum është i mirëseardhur, andaj duhet falënderuar z. Agim Veliun, për nënshkrimin e të njëjtit. Ky memorandum është edhe një dokument shtesë për përkujdesje që të mos braktiset shkollimi, pra angazhimi i strukturave përkatëse të jetë i vazhdueshmen në mënyrë që të gjithë nxënësit ta kryejnë shkollimin e obligueshëm.

4. Të ndryshme

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11.50’.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01-006-88068
Podujevë,
5 dhjetor 2016**

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**